

RREGULLORE

e kriterëve më të përafërta që duhet t'i plotësojnë edukatorët në aspektin e arsimit dhe përvojës së punës për zbatimin e punës provë të punonjësve shëndetësorë me arsim të lartë nga fusha e mjekësisë

shkurt 2017

Në bazë të nenit 120, paragrafi (2) të Ligjit të Mbrojtjes Shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15 dhe 192/15 dhe 17/2016) dhe neni 14 të Statutit të Odës së Mjekëve të Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/95, 30/95, 22/96 dhe 36/00), Kuvendi i Odës së Mjekëve të Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 10.11.2016, 17.11.2016 dhe 23.2.2017 miratoi

RREGULLORE

të kriterëve më të përafërta që duhet t'i plotësojnë edukatorët në aspektin e arsimit dhe përvojën e punës për zbatimin e punës provë të punonjësve shëndetësorë me arsim të lartë në fushën e mjekësisë

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret më të detajuara që edukatorët duhet t'i plotësojnë **në aspektin e arsimit dhe përvojës së punës** për zbatimin e punës provë në aspektin e aftësimin për dhënien e provimit profesional të punonjësve shëndetësorë me arsim të lartë në fushën e mjekësisë (në tekstin e mëtejme: edukatorët).

Neni 2

Puna provë kryhet në pajtim me planin dhe programin për punën provë të doktorëve të mjekësisë të miratuar nga ministri i Shëndetësisë.

II.KRITERET MË TË PËRAFËRTA QË DUHET T'I PLOTËSOJNË EDUKATORËT

Neni 3

Edukator është doktor i mjekësisë, nën mbikëqyrjen e të cilit zbatohet plani dhe programi i punës provë të doktorëve të mjekësisë.

Edukatori për zbatimin e punës provë të punonjësve shëndetësorë me arsim të lartë në fushën e mjekësisë i plotëson këto kriterë:

- mbarim të fakultetit të mjekësisë,
- pesë vjet përvojë në profesionin mjekësor nga marrja e licencës për punë,
- marrëdhënia e punës e bazuar në institucionin shëndetësor në kohë të pacaktuar
- të posedojë certifikata për edukim të vazhdueshëm mjekësor, të lëshuara nga shoqatat pranë Odës së Mjekëve të Maqedonisë, Fakultetit të Mjekësisë dhe shoqatave të tjera profesionale.

Neni 4

Edukatori në zbatimin e planit dhe programit për punën provë, nëpërmjet trajnimit praktik të punonjësve shëndetësorë, duhet të sigurojë:

- zbatimin e trajnimeve praktike të ndara nga plani dhe programi për punën provë,
- zbatimin e arsimit në institucionin ku është i punësuar dhe shfrytëzimi i hapësirave, pajisjeve dhe kushteve të tjera për edukimin praktik të kandidatit,
- mbajtjen e evidencës për zbatimin e punës provë,
- përcaktimin e literaturës së kandidatit nga fusha në të cilën e kryen arsimin,
- mbajtjen e më së shumti 5 kandidatëve të përcaktuar sipas vendbanimit/qëndrimit.

Neni 5

Oda e Mjekëve me vendim i përcakton edukatorët për zbatimin e punës provë të doktorëve të mjekësisë, pjesën e planit dhe programit në të cilin do ta zbatojnë punën provë dhe kohëzgjatjen për të cilën përcaktohen.

Edukatorët njoftohen me shkrim për pjesën e planit dhe programit të punës provuese në të cilën do ta kryejnë arsimin.

III DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 6

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, ndalon vlefshmëria e Rregullores së kriterëve që duhet t'i plotësojnë institucionet shëndetësore dhe punonjësit shëndetësorë, nën mbikëqyrjen e të cilëve zbatohet praktika e punonjësve shëndetësorë me arsim të lartë nga fusha e mjekësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.72/05).

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe do të publikohet me pajtim të Ministrit të Shëndetësisë.

Бр./ Nr. 02-3969/21
01.03. 2017год.

Претседател на
Лекарска комора на Македонија/
Kryetari i Odës së Mjekëve të Maqedonisë

Скопје/Shkup

Проф. д-р Кочо Чакалароски